

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË "VAN GORA" SHPK

Sot më datë 09/02/2024, palët e mëposhtme:

Marina Rama, atësia Mustafa, amësia Pashe, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. Gavril Dara, Nd. 14, H. 1, Njësia administrative nr. 1, 1004, Tiranë, gjendja civile e martuar, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila identifikohet me pasaportën me nr. BJ3224755, me numër personal I76210047G.

shpreh vullnetin e tij për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**VAN GORA**” **sh.p.k.** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**VAN GORA**” **sh.p.k.**, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Marina Rama, atësia Mustafa, amësia Pashe, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. Gavril Dara, Nd. 14, H. 1, Njësia administrative nr. 1, 1004, Tiranë, gjendja civile e martuar, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila identifikohet me pasaportën me nr. BJ3224755, me numër personal I76210047G.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**VAN GORA**” **sh.p.k.** do të jetë:

- Dhënia me qira e pasurive të paluajtshme. Ndërmjetësim për dhënie me qira të pasurive të paluajtshme.
- Çdo aktivitet tjetër që mund të kryejë një shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “**VAN GORA**” **sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën:
Rr. Panorama e Liqenit, Rezidenca Quite Lake, Shkalla 1, Apartamenti 14, Njësia Administrative Farkë, Tiranë.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **“VAN GORA” sh.p.k** është **Znj. Marina Rama**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **“VAN GORA” sh.p.k** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtuar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i vetëm

Znj. Marina Rama

